

## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 07/03/2023 (dy mijë e njëzet e tre), në selinë e Shoqërisë "LGR CONSTRUCTION" sh.p.k, paraqitën palët e mëposhtme:

**Shoqëria "EPIG" sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K81730002A, me seli në adresën Rr. "Kodra Derhemit", përfaqësuar nga Administratori **Z.Sotiraq Guga**, atësia Jorgo, amësia Liri, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë, dhe banues në Tiranë, lindur më 03/03/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letrnjoftim ID Nr. 037999207 dhe Nr. Personal G70303057N.

(këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**")

**Z.Sotiraq Guga**, atësia Jorgo, amësia Liri, shtetas shqiptar, lindur në Lushnjë, dhe banues në Tiranë, lindur më 03/03/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letrnjoftim ID Nr. 037999207 dhe Nr. Personal G70303057N.

(këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**")

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord të nënshkruajnë Kontratën e Shitjes të kuotave, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

### Neni 1

#### Objekti i kontratës

**1.1** Objekti i kontratës është shitja e **18% (tetëmbëdhjetë përqind)** të kapitalit që Shitësi, Shoqëria "EPIG" sh.p.k, zotëron në Shoqërinë "LGR CONSTRUCTION" sh.p.k, tek Blerësi, **Z.Sotiraq Guga**, përkundrejt çmimit të përcaktuar si më poshtë.

### Neni 2

#### Çmimi i shitjes.

**2.1** Çmimi total i shitjes së kuotës që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **180 Lekë (njëqind e tetëdhjetë lekë).**

### Neni 3

#### Mënyra e pagesës

**3.1** Palët deklarojnë se çmimi i shitjes së kuotës i përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, është likuiduar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

### Neni 4

#### Detyrimet e shitësit

- 4.1** Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotës objekt të kësaj kontrate, që ai zotëron në Shoqërinë "LGR CONSTRUCTION" sh.p.k, kuotë e cila tashmë i kalon Blerësit.
- 4.2** Shitësi garanton Blerësin se kuota e tij në kapital, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar dhe gëzon të drejta të plota mbi të.
- 4.3** Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë përfundimisht nga të drejtat që ai ka mbi kuotën objekt të kësaj kontrate.
- 4.4** Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

### Neni 5

#### Detyrimet e Blerësit

**5.1** Blerësi ka paguar çmimin e blerjes sipas menyrës së parashikuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër ndaj Shitësit.

5.2 Blerësi merr përsipër të kryejë të gjitha veprimet që nevojiten pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB) për kalimin e kuotës objekt kontrate në favor të tij.

**Neni 6**

**Konfigurimi pas shitje së kuotës**

6.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, kuota objekt i kësaj kontrate do të transferohet në rregjistrat e shoqërisë nga ortaku **Shoqëria "EPIG" sh.p.k** tek ortaku tjetër **Z.Sotiraq Guga**, me pjesëmarrje të re të kuotës të kësaj të fundit në Shoqërinë "LGR CONSTRUCTION" sh.p.k.

**NENI 7**

**Dispozitat Përfundimtare**

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**PALËT KONTRAKTUES**

**SHITËS :**

Shoqëria "EPIG" sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z.Sotiraq Guga

*Sotiraq Guga*



**BLERËS :**

Z.Sotiraq Guga

*Sotiraq Guga*